

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Polonia i ofron stimuj financiarë SHBA-së, teksa përparojnë bisedimet për bazën ushtarake
ADRESA	https://dosja.al/bota/polonia-i-ofron-stimuj-financiare-shba-se-teksa-perparojne-bisedimet-per-ba-i516167
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 13:09:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 13:07:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	31d1d795c546a5e8da13428ad667e7b77df29c17f8021a7b30c6c6e99729d20e
TEKSTI	9cd3f7af5749557d87f733b2d5dc268fd253604e4427411753b8da7b4bef8166
PAMJA	d13db88b4b69ffff3bf9b73fd5585d744e14d10f056947e7edd90683d86a6c52f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c6f03953d59c7524f40fd3346022d94a8f4550912fe135af28f94f68ceaa2c0a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7a6930be9f3749f4980fd84dca137394dacb19a29045da8941f5e341c088ecc2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c6f03953d59c7524f40fd3346022d94a8f4550912fe135af28f94f68ceaa2c0a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

6 MINUTA ME PARE

"Fjalim i turpshëm në OKB"/ Berisha: Rama është armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër Vetëvendosjes

1 ORE ME PARE

Shpërthimi i fuqishëm në lagjen Plaka në Greqi/ Humbin jetën 6 persona, mes tyre dhe 3 shqiptarë të pajetë në rrënoja (EMRAT+PAMJET)

2 ORE ME PARE

Zyrtarisht në detyrë/ Eric Wendt dorëzon letrat kredenciale, nis misionin si ambasador i SHBA-së në Shqipëri

2 ORE ME PARE

SPAK aksion në Shkodër e Tiranë/ Goditet grupi kriminal i trafikut të drogës! Urdhërarrest për Indrit Doklen, në pranga Bledar Çafi (VIDEO)

Bota

Polonia i ofron stimuj financiarë SHBA-së, teksa përparojnë bisedimet për bazën ushtarake

Teksa refuzoi të thoshte se cilat njësite amerikane mund të vendoseshin apo ku, Zalewski zbuloi detaje të reja të ofertës së Polonisë për Uashingtonin.



26 Shtator 2026, 15:07
Nga E.d



Donald Tusk dhe Donald Trump

Polonia po ofron që të paguajë 15.000 dollarë në vit për çdo ushtar amerikan të stacionuar në territorin e saj dhe po ofron mbulimin e kostove të infrastrukturës, teksa Varshava dhe Uashingtoni po afrohen drejt një marrëveshjeje për krijimin e një baze të përhershme ushtarake amerikane, tha për Radion Evropa e Lirë (REL) një zyrtar i lartë polak i mbrojtjes.

Zëvendësministri polak i Mbrojtjes, Pawel Zalewski, tha në një intervistë për Radion Evropa e Lirë më 25 shtator tha se negociatat me Pentagonin tani janë përqendruar në mënyrën e zbatimit të planit, përfshirë trupat, kapacitetet dhe lokacionet e mundshme.

"Po diskutojmë me Pentagonin variante të ndryshme të zbatimit të vendimit", tha Zalewski.

Teksa refuzoi të thoshte se cilat njësite amerikane mund të vendoseshin apo ku, Zalewski zbuloi detaje të reja të ofertës së Polonisë për Uashingtonin.

"Ne po ofrojmë kushte shumë speciale për trupat amerikane", tha ai.

"Ne do t'i mbulojmë kostot e infrastrukturës. Gjithashtu, po mbulojmë koston e secilit ushtar amerikan të stacionuar në Poloni me 15.000 dollarë në vit".

I pyetur se kush do të paguante, Zalewski u përgjigj: "Paguhet nga taksapaguesit polakë".

Oferta vë në pah vendosmërinë e Varshavës për të siguruar një prani të përhershme ushtarake amerikane, teksa Pentagoni po shqyrton dislokimin e forcave amerikane në të gjithë Evropën.

editoriale

Auron Janku
"Washingtonët" tanë

Eriseld Zeneli
Shqipëria, socializmi i Edi
Ramës pa të majtën

Në vëmendje

AKTUALITET 26 SHTATOR 2026, 14:13

Atentati në Athinë/ Në shënjestër 30-vjeçari Denis Luli! Dyshimet se urdhri u dha nga Klodian Lekocaj, i njohur si kreu i mafies së burgjeve

AKTUALITET 26 SHTATOR 2026, 11:36

Në kërkim nga SPAK/ Si i shpëtoi policisë ish-anëtari i bandës së Durrësit Indrit Dokle! Planet e Ervis Martinajt për ta eliminuar dhe armiku i Lul Berishës

Presidenti amerikan, Donald Trump, tha më 17 shtator se po bëhej përparim drejt krijimit të një baze të ushtrisë amerikane në Poloni dhe se për vendndodhjen e saj mund të njoftohej së shpejti.

Shtetet e Bashkuara tashmë kanë mijëra trupa në Poloni, kryesisht ata dislokohen me rotacion, dhe vendi është shndërruar në një qendër të rëndësishme për operacionet e NATO-s përgjatë krahut lindor të aleancës.

Zalwski tha se detajet e çdo dislokimi të përhershëm janë duke u negociuar dhe po diskutohen në kuadër të shqyrtimit më të gjerë të Uashingtonit për qëndrimin e tij ushtarak në Evropë.

“Po diskutojmë variante të ndryshme, lloje të ndryshme të trupave, kapaciteteve dhe lokacioneve”, tha ai, duke shtuar se Varshava pret më shumë qartësi pasi të përfundojë procesi i shqyrtimit.

Pentagoni nuk lu përgjigj menjëherë kërkesave për koment.

Për Varshavën, rëndësia e një baze të përhershme shkon përtej numrit të trupave të stacionuara atje.

“Bazat e përhershme krijojnë angazhim të përhershëm”, tha Zalwski, duke shtuar se një dislokim i tillë do të ishte më pak i varur nga ndryshimet në mjedisin politik apo ushtarak, teksa njëkohësisht do t'i dërgonte një sinjal të drejtpërdrejtë Moskës.

Një sulm ndaj Polonisë, tha ai, do të rrezikonte t'i fuste forcat ruse në konflikt të drejtpërdrejtë me trupat amerikane.

“Ky është një mesazh shumë i rëndësishëm dhe urgjent për presidentin [rus, Vladimir] Putin se SHBA-ja ka interesa strategjike në Poloni dhe se sulmi ndaj Polonisë do të ishte sulm ndaj forcave të armatosura amerikane në Poloni”, tha Zalwski.

Ai argumentoi po ashtu se prania e përhershme amerikane nuk duhet të shihet thjesht si një favor që Uashingtoni po i bën Varshavës.

“Kjo bazë e përhershme nuk është rezultat i një lloj altruizmi”, tha ai, por sipas tij, pasqyron “interesa amerikane”.

Polonia ka zgjeruar me shpejtësi ushtrinë e saj dhe ka investuar shumë në sistemet amerikane të armatimit. Dy vendet kanë thelluar edhe lidhjet energjetike, përfshirë bashkëpunimin me kompanitë amerikane për termocentralin e parë bërthamor të Polonisë.

Ekspertët e sigurisë thanë se një bazë e përhershme do ta forconte angazhimin e Uashingtonit ndaj krahut lindor të NATO-s, por paralajmëruan se rëndësia e saj do të varej pjesërisht nga ajo që do të ndodhë me forcat amerikane në vendet e tjera në Evropë.

“Një bazë e përhershme amerikane në Poloni do të ishte një sinjal i rëndësishëm i angazhimit amerikan ndaj krahut lindor të NATO-s, veçanërisht teksa Uashingtoni po shqyrton qëndrimin e tij më të gjerë ushtarak në Evropë”, tha për Radion Evropa e Lirë David Cattler, ish-ndihmëssekretar i përgjithshëm i NATO-s për inteligjencën dhe sigurinë.

Por, Cattler, tani bashkëpunëtor i lartë në Qendrën për Politika dhe Analiza Evropiane, tha se aleatët do të vëzhgojnë rezultatin më të gjerë të shqyrtimit amerikan.

“Aleatët do ta gjykojnë të gjithë tablonë: cilat forca dhe kapacitete do të mbeten, sa shpejt mund të përforcojnë Poloninë dhe shtetet baltike dhe nëse mund të operojnë së bashku në mënyrë efektive”, tha ai.

“Një bazë do ta forconte parandalimin nëse i shton krahut lindor kapacitete reale. Ajo do të bënte shumë më pak për t'i siguruar aleatët nëse shoqërohet me reduktime të konsiderueshme të pranisë amerikane diku tjetër në Evropë”.

Matthew Boyse, bashkëpunëtor i lartë në Institutin Hudson dhe ish-zëvendësndihmëssekretar amerikan i Shtetit për çështjet evropiane dhe euroaziatike, tha se negociatat pasqyrojnë rolin në rritje të Polonisë në NATO.

“Këto bisedime për bazën tregojnë vlerën e vazhdueshme të Polonisë si një aleate e madhe e NATO-s”, tha Boyse për Radion Evropa e Lirë.

Polonia ka rritur ndjeshëm shpenzimet për mbrojtjen vitet e fundit dhe është shndërruar në një nga vendet e NATO-s që shpenzojnë më shumë për ushtrinë në raport me madhësinë e ekonomisë së tyre.

“Në vend se të ankohet për ‘besueshmëri’, Polonia po bën gjithçka që mundet”, tha Boyse. “Administrata e shëh dhe e vlerëson këtë”.

Charles Kunchan, bashkëpunëtor i lartë në Këshillin për Marrëdhënie me Jashtë, tha se mundësia e një baze të

AKTUALITET 26 SHTATOR 2020, 11:14

U arrestua nga SPAK gjatë operacionit “Muri i Lartë”/ Kush është Bledar Çafi, “i forti” i Shkodrës ndër vite i përfshirë në botën e krimit

më të klikuarat

VIDEO/ Pamje të rënda nga atentati në Sarandë! Artan Myrtaj vrapon për tu shpëtuar plumbave, autorët e ndjekin dhe qëllojnë në mes të rrugës

Në kërkim nga SPAK/ Si i shpëtoi policisë ish-anëtari i bandës së Durrësit Indrit Dokle! Planet e Ervis Martinajt për ta eliminuar dhe armiku i Lul Berishës



SPAK operacion në Shkodër e Tiranë/ Goditet një grup kriminal i trafikut të drogës! Urdhërarrest për Indrit Doklen, në pranga Bledar Çafi (VIDEO)

Të shtëna me armë zjarri në një lokal në Athinë/ Plagoset 10-vjeçarja shqiptare, gjendet i djegur mjeti i autorëve (FOTOT)

insights

Bledian Koka

Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj

Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani

Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Moti

Powered by tomorrow.

përhershme do të mirëpritej në vendet më të afërta me Rusinë, por paralajmëroi se mbetet pasiguri për qasjen më të gjerë të Uashingtonit ndaj Evropës.

“Mundësia e një baze të përhershme amerikane në Poloni është lajm i mirë për polakët dhe të tjerët përgjatë krahut lindor të NATO-s, veçanërisht mes shqetësimeve në rritje për kërcënimin që paraqet Rusia”, tha Kupchan për Radion Evropa e Lirë.

“Megjithatë, kjo është ende një periudhë pasigurie për NATO-n”, tha ai duke iu referuar marrëdhënies që ndonjëherë është e tensionuar mes Trumpit dhe aleatëve dhe shqyrtimit të Pentagonit, i cili mund të reduktojë praninë amerikane në vende të tjera të Evropës.

Përpjekjet e Varshavës për një prani të përhershme amerikane vijnë në kohën kur Rusia duket gjithnjë e më e gatshme të marrë rreziqe ndaj anëtarëve të NATO-s.

“Gatishmëria e Rusisë për të pranuar rrezik më të madh është e dukshme dhe Rusia është e gatshme të përshkallëzojë situatën”, tha Zalewski.

Ai iu referua incidenteve të fundit që Polonia i ka lidhur me Rusinë, përfshirë shkeljet e hapësirës ajrore dhe aktet e dyshuara të sabotimit, duke thënë se ato ilustrojnë presionin me të cilin përballen vendet në krahun lindor të NATO-s.

Polonia, tha ai, po përgjigjet si përmes aleancës së saj me SHBA-në, ashtu edhe përmes NATO-s.

Për Varshavën, një bazë e përhershme amerikane do t’i shtonte një shtresë tjetër këtij parandalimi, duke e bërë të qartë se çdo përballje ushtarake që përfshin Poloninë mund të përfshijë menjëherë edhe forcat amerikane.

“Bazat e përhershme krijojnë angazhim të përhershëm”, tha Zalewski./REL

uashingtoni polonia sonald trump

Sondazh

Poll

Bota

26 Shtator 2025, 14:46

Pezullohen fluturimet drejt Katanias, shkak hiri vullkanik nga Etna

hiri vullkanik nga Etna ITALI- Fluturimet në aeroportin e Katanias, në Sicili, janë pezulluar për shkak të hirit vullkanik...

Vuçiç bisedon me Putinin, shprehet i bindur se marrëveshja për gazin me Rusinë do të arrihet

Bota

26 Shtator 2026, 14:00

**Konflikti në Lindjen e Mesme/
Ambasadori amerikan: Trump e
paralajmëroi Xinë që të mos e mbështesë
Iranin**

Bota

26 Shtator 2026, 13:30

**Konkurrenca për zhvillimin e
teknologjisë së avancuar, SHBA-të dhe
Kina krijojnë kanal komunikimi për
Inteligjencën Artificiale**

Bota

26 Shtator 2026, 13:23

**Katastrofë përmytjesh në Tajlandë/
Bangkoku zhytet nën ujë, shpallet
gjendje katastrofe në 50 distrikte
(VIDEO)**

Bota

26 Shtator 2026, 10:01

Bota

26 Shtator 2026, 09:28

Sulm kibernetik ndaj FBI-së/ Hakerët pretendojnë se kanë vjedhur të dhënat mjekësore të mijëra agjentëve

foto ilustruese SHBA- Hakerët që kanë sulmuar sistemet e FBI-së
pretendojnë se disponojnë të dhëna jashtëzakon...

**A mund të bëhet Bjellorusia furnizuese
kryesore e SHBA-së me potas?**

Bota

26 Shtator 2026, 09:22

**Trump refuzon armëpushimin 7-ditor të
proponuar nga Irani, pritët të rifillojë
bombardimet pas zgjedhjeve të nëntorit**

[Bota](#)

26 Shtator 2026, 08:46

**Partitë e ekstremit të djathtë dhe të majtë
festojnë sukses pas suksesi/ Analiza e
DW: Pse po i tremb kjo njerëzit**

[Bota](#)

26 Shtator 2026, 08:37

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.